

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E BURIMEVE DHE E PËRDORIMIT TË FONDEVE	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË PASURINË NETO	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-17

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Drejtimit dhe Këshillit Drejtues të Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar bashkëngjitur, të cilat përfshijnë bilancin kontabël më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në pasurinë neto për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me kontabilitetin sipas bazës së modifikuar të parasë siç paraqitet në Shënimin 2(a) të këtyre pasqyrave financiare dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethanat të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar më 31 dhjetor 2015 dhe rrjedhën e parasë dhe ndryshimin në pasurinë neto për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me parimet kontabël të bazës së modifikuar të parasë siç paraqitet në Shënimin 2(a) të këtyre pasqyrave financiare.

15 prill 2016

Tiranë, Shqipëri

Mirjeta Emini

Ekspert Kontabel i Autorizuar
Rruga Ibrahim Rugova, Tirane
+355682021329

Rajmonda Reveli

Ekspert Kontabel i Autorizuar
Rruga Budi, Tirane
+355682396755

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënime	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2015	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2014
AKTIVE			
Aktive Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	71,962,600	63,499,952
Llogari të arkëtueshme	5	3,836,583	3,489,431
Inventarët	6	341,912	211,692
Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)	7	3,131,876	1,839,515
Totali i aktiveve afatshkurtra		79,272,971	69,040,590
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	40,477,783	43,247,943
Totali i aktiveve afatgjata		40,477,783	43,247,943
TOTALI I AKTIVEVE		119,750,754	112,288,533
DETYRIMET DHE PASURIA NETO			
Detyrime			
Llogari të pagueshme	9	4,981,517	4,212,942
Detyrime ndaj Autoritetit të Çertifikimit	9	6,173,734	5,511,524
Detyrime të tjera (kuota variabël)	7	760,778	1,407,278
Detyrime tatimore	10	256,081	344,183
Të ardhura të periudhave të ardhshme	11	992,904	1,199,160
Totali i detyrimeve afatshkurtra		13,165,014	12,675,087
Totali i Detyrimeve		13,165,014	12,675,087
PASURIA NETO			
Teprica e burimeve në fillim të periudhës		99,613,446	86,574,010
Pakësime gjatë vitit	12	-	(354,811)
Teprica e burimeve të vitit financiar	17	6,972,294	13,394,247
Totali i Pasurise neto		106,585,740	99,613,446
TOTALI I DETYRIMEVE DHE PASURISE NETO		119,750,754	112,288,533

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. **xx**, datë .04.2016 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Hysen ÇELA
Kryetar i Këshillit Drejtues

Elvira HOXHA
Drejtor Ekzekutiv

Shënimet nga 7 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e Burimeve dhe Përdorimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

		Ushtrimi i mbyllur 31.12.2015	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2014
	Shënime		
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtarite kryesore	13	30,208,171	33,738,299
i. Kuotat e anëtarësimit të E.K.R., shoqërive dhe stazhierëve		29,100,056	31,592,174
ii. Të ardhura të tjera		1,108,115	2,146,125
Burimet nga kualifikimi i E.K.R. dhe stazhierë	15	2,076,350	3,473,500
Burimet nga publikimet	16	701,400	393,000
Totali i burimeve - të ardhurave		32,985,921	37,604,799
PERDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore	14	(23,527,756)	(22,784,986)
i. Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit		(5,701,296)	(5,502,633)
ii. Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete etj		(5,893,860)	(7,352,040)
iii. Shpenzime administrative dhe të tjera		(11,932,600)	(9,930,313)
Shpenzime kualifikimi i E.K.R. dhe stazhierëve	15	(2,870,518)	(3,102,383)
Shpenzime për botime	16	(300,933)	(536,645)
Totali i përdorimit të fondeve		(26,699,207)	(26,424,014)
Teprica (deficiti) burimeve nga veprimtaria kryesore		6,286,714	11,180,785
Të ardhura nga kursi i këmbimi		12,051	8,765
Të ardhura nga interesat		673,529	2,204,697
Te ardhura (shpenzime) financiare		685,580	2,213,462
Teprica (deficiti) neto i burimeve për vitin	17	6,972,294	13,394,247

Shënimet nga 7 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e Burimeve dhe Përdorimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Përdorime të fondeve për vitin	6,9725,294	13,394,247
Rregullime për:	3,683,863	3,745,427
Amortizimin	3,753,863	3,745,427
Fitimin nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(70,000)	-
Rritje/rënie në aktivet afatshkurtra	(1,769,733)	(1,952,898)
Rritje/rënie në detyrimet afatshkurtra	489,928	(4,055,361)
Rrjedha e parasë e përfituar nga aktivitetet e shfrytëzimit	9,376,352	11,131,415
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(983,704)	(3,287,540)
Shitja e aktiveve afatgjata materiale	70,000	-
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	(913,704)	(3,287,540)
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë financiare		
Pagesat e detyrimeve të kualifikimit dhe detyrime të tjera	-	(354,811)
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet financiare	-	(354,811)
Rrjedha neto e parasë	8,462,648	7,489,064
Mjetet monetare në fillim të vitit (Shënimi 4)	63,499,952	56,010,888
Mjetet monetare në fund të vitit (Shënimi 4)	71,962,600	63,499,952

Shënimet nga 7 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pasqyra e pasurisë neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Pasuria neto	Teprica e burimeve të vitit	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2013	95,266,196	(8,692,185)	86,574,010
Teprica e burimeve për periudhën kontabël	-	13,394,247	13,394,247
Kalimi i tepricës së burimeve të vitit në pasurinë neto	(354,811)	-	(354,811)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	94,911,384	4,702,062	99,613,446
Teprica e burimeve për periudhën kontabël	-	6,972,294	6,972,294
Kalimi i tepricës së burimeve të vitit në pasurinë neto	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	94,911,384	11,674,356	106,585,740

Shënimet nga 7 deri në 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë “IEKA” ose “Instituti”), është një shoqatë profesionale që grupon Ekspertët Kontabël të Regjistruar dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistëve të miratuar”, me Ligjin për “Organizatat jo-fitimprurëse” dhe me statutin e tij.

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Ekspertëve Kontabël të Regjistruar vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në “Rruga e Elbasanit”, pallati Edil Al - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKAs.

Politika e Institutit deri në fund të vitit 2013 është të paraqesë pasqyrat financiare sipas bazës së modifikuar të arkëtim-pagesave (cash basis modified). Në bazë të kësaj politike të ardhurat fillimisht janë njohur kur arkëtimi është kryer dhe jo kur janë fituar apo realizuar dhe shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur, pavarësisht nëse pagesat janë kryer ose jo. Për më tepër baza kontabël e arkëtimit dhe pagesave është modifikuar në mënyrë që të drejtat (përveç kuotave të ndryshme) dhe detyrimet të njihen kur efektet financiare janë realizuar ose kanë ndodhur (janë konstatuar).

Duke filluar nga viti 2014, IEKA ka llogaritur edhe kuotat e ndryshme (përfshire edhe ato variabël) bazuar në parimin e të drejtave të konstatuara.

Politikat kontabël si më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Ndryshim i politikës kontabile për njohjen e të ardhurave nga kuota variabile

Mbështetur në vendimin nr. 14, datë 28 dhjetor 2012 të Këshillit Drejtues, në 1 janar 2013 Instituti ndryshoi politikën e njohjes së të ardhurave për kuotën variabël. Sipas këtij vendimi “Shumat e të drejtave/ detyrimeve lidhur me deklaratimet dhe pagesat e kuotës variabël të EKR të azhurnuara deri më 31 Dhjetor 2015 janë përfshirë në llogaritë përkatëse të EKR-ve dhe shoqërive të auditimit.

Në përputhje me politikën e re kontabël të ardhurat nga kuota variabël do të njihen në momentin e deklaratimit të kuotës variabël në shumat e përlllogaritura bazuar në tabelat e misionëve të deklaruara prej EKR-ve dhe shoqërive të auditimit dhe pagesat e kryera gjatë vitit do të ulin detyrimin për kuotën variabël të deklaruar e të papaguar.

(d) Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, veprimtaria ekonomike e IEKA-s parashikon se do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet e saj dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Institutit janë prezantuar në Lek shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale e Institutit. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

Parimet kontabël kryesore të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare janë si më poshtë:

(b) Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 janë njohur mbi bazën e modifikimit të njohjes së të ardhurave, për kuotën fikse vjetore për anëtar dhe për kuotat variabël të llogaritur si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara nga secili anëtar. Shuma e kuotës fikse dhe përqindjes së kuotës variabël janë përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 30 qeshor 2010 (vendimi nr. 73). Masa e kuotës fikse dhe asaj variabël janë respektivisht si më poshtë :

	2015	2014
Kuota fikse	100,000	100,000
Kuota variabël	0.5%	0.5%

Në burimet e Institutit përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, siç janë publikimet profesionale, nga kualifikimi i vijueshëm dhe nga anëtarët e rinj. Për secilën kategori të këtyre burimeve të fondeve është paraqitur edhe shuma përkatëse e shpenzimeve.

Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit 2015 dhe shpenzimet e kryera për vitin 2015, por që nuk janë paguar në fund të vitit.

(c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014, ka qënë respektivisht si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
U.S Dollar (USD)	125.79	115.23
Euro (Euro)	137.28	140.14

(d) Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi më pak se një vit.

(e) Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike. Instituti ka filluar të përlllogarisi vlera të arkëtueshme nga kuotat fikse të anëtarëve vetëm më 31 dhjetor 2012.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me vlerën e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar. Politika e llogaritjes së zhvlerësimit ka filluar të aplikohet për herë të parë nga 1 janari 2009. Shtesat e aktiveve afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të blerjes të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë aktivin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Zhvlerësimi është llogaritur me metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitet, duke aplikuar normat e mëposhtme të amortizimit (sipas IEKA-s):

Kategoria e aktiveve fikse	Normat e zhvlerësimit	
	2015	2014
Ndërtesa	5%	5%
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%

Për vitin 2011, është aplikuar llogaritja e zhvlerësimit për herë të parë për ndërtesat.

(g) Teprica dhe defiçiti i burimeve

Teprica / defiçiti midis burimeve dhe përdorimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në pasurinë neto të IEKA.

(h) Tatimi mbi fitimin

IEKA është institut jofitimprurës. Si i tillë, Instituti nuk paguan tatim mbi fitimin. Instituti respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

(i) Kontributet për sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Shoqëria paguan kontributet për pensione si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

4. Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Paraja në bankë	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Intesa SanPaolo (Lekë)	13,775,769	9,105,157
Intesa SanPaolo (Euro)	6,705	93,451
Intesa SanPaolo (USD)	33,804	37,880
Shuma ekuivalente në Lekë	13,816,278	9,236,488
Banka Kombëtare Tregtare (Lekë)	83,009	146,892
Banka Kombëtare Tregtare (Euro)	43,251	458,200
Banka Kombëtare Tregtare-Provimet (Lekë)	6,638,357	5,074,168
Shuma ekuivalente në Lekë	6,764,617	5,679,260
Raiffeisen Bank (Lekë)	10,070,382	7,442,399
Raiffeisen Bank (USD)	59,122	55,541
Shuma ekuivalente në Lekë	10,129,504	7,497,940
Depozita me afat	41,126,968	40,670,630
Totali në bankë	71,837,367	63,084,318
Paraja në arkë		
Paraja në arkë (Lekë)	79,219	48,568
Paraja në arkë (Lekë)	29,642	39,142
Paraja në arkë (Euro)	7,441	320,693
Paraja në arkë (USD)	8,931	7,231
Totali në arkë	125,233	415,634
Totali	71,962,600	63,499,952

Në llogaritë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare është përfshirë shuma për t'u paguar ndaj Autoritetit të Çertifikimit prej 6,173,734 Lekë (2014: 5,511,524 Lekë) (referojuni gjithashtu Shënimit 9).

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjete monetare (vazhdim)

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit, paraqiten si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Depozita me afat 6 muaj		
Banka Kombëtare Tregtare	-	15,000
Depozita me afat 12 muaj		
Banka Kombëtare Tregtare	15,027,237	15,027,237
Intesa SanPaolo	7,500,000	7,500,000
Credins Bank	18,599,731	18,128,393
Totali	41,126,968	40,670,630

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 të ardhurat nga interesi janë 673,529 Lekë (31 dhjetor 2014: 2,204,697 Lekë).

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të detajuara si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
E.K.R. pasiv, kuotë fikse	1,965,413	2,068,371
E.K.R. kuotë fikse pjesore	1,832,670	706,160
E.K.R. penalitete kuota fikse	1,832,670	441,400
Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar	38,500	273,500
Totali	3,836,583	3,489,431

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

6. Inventarët

Inventarët janë të përbërë si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Kodi Etikës	6,370	12,740
SNA	68,640	81,120
Guida	91,350	91,350
Revista	57,928	26,482
Udhërrëfyese	104,124	-
Të tjera	13,500	-
Totali	341,912	211,692

7. Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)

Të arkëtueshme të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit ndaj anëtarëve të tij në lidhje me kuotën variabël. Këto të drejtat lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më pak se misionet e deklaruar. Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2015 janë 3,131,876 Lekë (31 dhjetor 2014: 1,839,515 Lekë).

Detyrime të tjera përfaqësojnë detyrimet e Institutit ndaj anëtarëve të tij për kuotën variabël. Këto detyrime lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më shumë se misionet e deklaruar. Detyrimet për kuotën variabël më 31 dhjetor 2015 janë 760,778 Lekë (31 dhjetor 2014: 1,407,278 Lekë).

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë :

	Ndërtesa	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje elektronike	Total
Kosto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	47,455,444	3,273,550	9,557,608	60,286,602
Shtesa	-	-	983,704	983,704
Pakësime	-	-	(1,327,062)	(1,327,062)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	47,455,444	3,273,550	9,214,250	59,943,244
Zhvlerësimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2014	9,491,086	136,398	7,411,175	17,038,659
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(1,327,062)	(1,327,062)
Zhvlerësimi	949,408	654,710	2,149,745	3,753,863
Gjendja më 31 dhjetor 2015	10,440,494	791,108	8,233,858	19,465,460
AAM Vlëra Kontabël Neto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	37,964,358	3,137,152	2,146,433	43,247,943
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	37,014,950	2,482,443	980,392	40,477,783

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Zëri “Ndërtesa” rezulton me vlerë bruto 47,455,444 Lekë më 31 dhjetor 2015. Ende nuk është marrë titulli i pronësisë për zyrat e IEKA nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Megjithatë, ato janë konsideruar si aktive afatgjata materiale të IEKA-s.

9. Llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj Autoritetit të Çertifikimit

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Komiteti i Cilësisë	902,000	873,085
Bordi i Mbrojtjes Publike	840,000	840,000
Komiteti i Edukimit	44,700	-
Këshilli i Drejtimit	27,000	27,000
Auditimi i pasqyrave financiare	-	201,340
Totali	1,813,700	1,941,425
EDIL AL-IT	609,594	609,594
Detyrime për AC (mbledhja dhjetor, qira sallash, regjistri)	714,431	376,101
11 Kandidatë KM tarifë regjistrimi në provime	132,000	132,000
Detyrime ndaj të tretëve	33,934	33,934
Telekomunikacion	14,284	23,575
CEZ (OSSH)	13,392	23,173
Ujësjetlesi	2,270	1,870
Albtelecom	8,383	-
Posta Shqiptare	14,340	-
APG shpk	983,704	-
Geci shpk	463,200	-
Alb Paper	-	378,300
Vitrina Franceze	-	322,000
Future University	-	117,600
APA-Albpartner	6,000	55,200
Të tjerë	172,285	198,170
Totali	3,167,817	2,271,517
Totali llogari të pagueshme	4,981,517	4,212,942

9. Llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj Autoritetit të Çertifikimit (vazhdim)

Të pagueshme ndaj Autoritetit të Çertifikimit përfaqëson detyrime për t'u paguar nga IEKA për tarifat e regjistrimit të provimit që lidhen me procesin e çertifikimit.

	Ushtrimi i mbyllur me 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur me 31 dhjetor 2014
Teprica e vitit të kaluar	5,511,523	6,179,456
Teprica (deficit) i vitit	662,211	(667,933)
Totali i detyrimeve për Autoritetin e Çertifikimit	6,173,734	5,511,523

Pasqyrat financiare të burimeve dhe të përdorimit të fondeve të procesit të çertifikimit janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 10091, datë 5 maj 2009 "Për auditimin ligjor...". Më 31 dhjetor 2015, të ardhurat e procesit të çertifikimit janë në shumën 5,110,000 Lekë (për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014: 4,720,000 Lekë), ndërsa përdorimet 4,447,790 Lekë (për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014: 5,387,933 Lekë). Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2015 është shtese prej 662,211 Lekë. Totali neto i cili përfshin edhe atë të trashëguar nga vitet e kaluara ndodhet në llogaritë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare dhe mbartet për procesin e ardhshëm të çertifikimit.

10. Detyrime tatimore

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	181,087	266,656
Sigurime shoqërore	74,994	77,527
Totali	256,081	344,183

11. Të ardhura të periudhave të ardhshme

IFAC, IEKAs dhe SHKÇAK kanë lidhur një marrëveshje trepalëshe me qëllim uljen e kostove të përkthimit si dhe në kuadër të unifikimit të terminologjisë profesionale me fushëveprimi përkthimet e dokumentave të Bordeve të IFAC siç janë Guidat, Kodet e Etikes dhe dokumenta e propozime të tjera të publikuara nga IFAC. Nga shuma prej 839,300 Lekë e cila është arkëtuar nga SHKÇAK për përkthimet që do të kryhen në vitin 2015 e në vazhdim është pakësuar me shumën 240,000 Lekë për Udherrefyesin (200 copë) që i është dërguar SCAAK gjatë vitit 2015. Shuma më 31 Dhjetor 2015 për t'u përdorur në vitet e ardhshme mbetet 599,300 Lekë.

Në këtë zë janë grupuar edhe disa pagesa të kuotave të kryera më tepër (kuota fikse të E.K.R., kuota të stazhierëve, të kandidatëve për provime EKR/KM etj.) që do të konsiderohen për vitin në vijim në shumën 425,404 Lekë. Diferenca prej 31,800 Lekë është shpenzim i parapaguar.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

12. Ndryshime në pasurinë neto

Gjatë vitit 2015 pasuria neto e IEKA-s është shtuar me shumën 6,972,294 Lekë që është teprica e burimeve e vitit financiar.

13. Burimet e përdorimeve nga veprimtaria kryesore

Burimet e përdorimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Nga kuota fikse E.K.R.	21,983,073	20,827,880
Nga kuota variabël E.K.R.	4,711,033	6,437,854
Nga kuota e regjistrimit në stazh	1,750,000	3,400,000
Nga kuota fikse E.K.R. pasiv	255,333	1,312,125
Të ardhura të tjera	1,273,732	1,195,440
Nga kuota e regjistrimit të shoqërive	235,000	565,000
Totali	30,208,171	33,738,299

Në Janar të vitit 2015, me hyrjen në fuqi të ndryshimit të Statutit të IEKA për afatin e deklarimit të misionëve të EKR dhe shoqërive (nga 31 mars u vendos në 25 janar) u regjistruan në të ardhurat nga kuota variabël edhe të ardhurat sipas deklarimit të misionëve për vitin 2014.

Të ardhurat nga kuota variabël përfaqësojnë të ardhurat sipas deklarimit të misionëve të EKR-ve për vitin 2015. Kuotat e E.K.R. pasiv të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 nuk janë regjistruar në të ardhura meqenëse Drejtimi i Institutit vlerëson si mjaft të vështirë mbledhjen e tyre. Një pjesë e E.K.R. pasiv ndodhet jashtë Shqipërisë, një pjesë tjetër nuk paguajnë dhe nuk ka një mekanizëm që t'i detyrojë këta E.K.R. të kryejnë pagesën gjatë periudhës që janë pasiv.

14. Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore

Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 15	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 14
Pagat e punonjësve	5,149,455	4,953,455
Sigurimet shoqërore	551,841	549,178
Nën totali - Pagat e punonjesve dhe siurimet shoqerore	5,701,296	5,502,633
Honorare drejtimi, KKB, Audituesi i PF	4,290,660	4,200,340
Honorare për Autoritetin e Regj. dhe komitete	1,603,200	3,151,700
Nën totali - Drejtimi, Autoritetet, Honoraret e Komiteteve	5,893,860	7,352,040

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Shpenzime udhëtimi turistik	2,135,700	-
Shpenzime amortizimi	3,753,863	3,745,437
Kuota regjistrimi në organizma profes.	1,277,420	1,657,213
Udhëtime e dieta	1,664,739	1,799,066
Telefon, internet	426,113	564,865
Energji, ujë	295,964	240,782
Kancelari	127,000	156,062
Shpenzime të tjera	2,251,801	1,766,888
Nën totali - Shpenzime admin. dhe të tjera	11,932,600	9,930,313
Totali	23,527,756	22,784,986

Më 31 dhjetor 2015 Instituti ka 4 punonjës me kohë të plotë dhe 2 punonjës me kohë të pjesëshme (31 dhjetor 2014: 4 punonjës me kohë të plotë dhe 2 punonjës me kohë të pjesëshme).

Diferenca midis Burimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 13) dhe Përdorimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 14) përbën Tepricën nga veprimtaria kryesore prej 6,680,415 Lekë (2014: 10,953,313 Lekë).

15. Burimet dhe përdorimet e fondeve për kualifikimin e E.K.R. dhe stazhierëve

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Burimet e fondeve nga kualifikimi E.K.R.	140,000	190,000
Burimet e fondeve nga stazhierët	1,339,350	1,663,500
Burimet nga trajnimi SKK/SNK	597,000	1,620,000
Totali	2,076,350	3,473,500
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e E.K.R.	(1,105,908)	(1,030,423)
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e stazhierëve	(1,342,510)	(1,200,310)
Përdorimet nga trajnimi SKK/SNK	(422,100)	(871,650)
Totali	(2,870,518)	(3,102,383)
Teprica nga kualifikimet për E.K.R. dhe stazhierët	(794,168)	371,117

16. Burime dhe përdorime nga botimet

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Totali i të ardhurave nga botimet	701,400	393,000
Totali i shpenzimeve nga botimet	(300,933)	(536,645)
Teprica / (defiçiti) nga botimet	400,467	(143,645)

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

17. Teprica / (defiçiti) neto i burimeve të vitit

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2014
Teprica nga veprimtaria kryesore	6,680,415	10,953,313
Teprica / (defiçiti) nga kualifikimet	(794,168)	371,117
Teprica / (defiçiti) nga botimet	400,467	(143,645)
Të ardhura financiare	685,580	2,213,462
Teprica / (defiçiti)	6,972,294	13,394,247

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës 31 dhjetor 2015 e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.